



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1444/3 prot.

Tiranë, më 11/01/2019

Drejtuar: Agjencisë së Prokurimit Publik
Buletini i Njoftimeve Publike

Tiranë

Lënda: Botim Njoftimi.

Rektorati i Universitetit të Arteve, shpall konkursin për 2 (dy) vende të lira pune për punonjës mësimorë nga kategoria “Asistent Lektor” si më poshtë:

- I. NJËSIA BAZË AKTRIM & TEORI ARTI - 1 (një) punonjës mësimorë;
- II. NJËSIA BAZË REGJI, REGJI FIMI & TELEVISIONI - 1 (një) punonjës mësimorë;

Sa më poshtë, kërkesat dhe kriteret specifike për sejcilin pozicion pune.

I. NJËSIA BAZË AKTRIM & TEORI ARTI:

1. Punonjës mësimorë nga kategoria Lektor për lëndën Kërcim Skenik - 1 (një) punonjës;

1.1. Kandidati/ët për konkursin e Punonjësit mësimorë nga kategoria “As. Lektor”, për lëndën

Kërcim Skenik duhet të plotësojnë këto kriteret:

- të ketë kryer studimet në arsimin e lartë në profilin përkatës 4 -vjeçar/ master shkencor ose master në arte (mesatarja e përgjithshme e notave mbi 8) në Universitetin e Arteve. Në rastet kur studimet janë kryer në një shkollë të lartë në arte jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njehsuar në MARS;
- të ketë kualifikime/specializime/kurse trajnimi në specialitetin për të cilin konkurron;
- të ketë përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë në fushën përkatëse, brenda ose jashte Shqipërie minimumi 3 (tre) vjet;
- të ketë realizuar aktivitete artistike të fushë në skenë apo televizion (minimumi 3 aktivitete);
- të ketë dëshmi kompjuterike (programet bazë);
- të ketë dëshmi të njërës prej gjuhëve të huaja (Anglisht, Frengjisht, Gjermanisht, Italisht, Rusisht);
- të ketë 2 (dy) rekomandime nga profesorë të fushës;
- të dëshmojë etikë të lartë profesionale dhe morale;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

- të mos ketë penalizime nga punëdhënësit e mëparshëm në drejtim të etikës profesionale dhe marrëdhënie me kolegët;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kandidati duhet të dorëzojë pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, këto dokumenta:

1. Kërkesë ku të jetë përcaktuar pozicioni i punës për të cilin ai konkuron;
2. Diplomë origjinale + fletë notash/fotokopje e noterizuar (shkollë e lartë në profilin përkatës për arte, mesatare e përgjithshme mbi 8) e Fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga MASR;
3. Çertifikate origjinalee/fotokopje e noterizuar e kualifikimit/specializimit/trajnimit të kryer;
4. Jetëshkrim (CV) shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që vërteton elementët e paraqitur në të (studimet; aktiviteti artistik; përvija pedagogjike si dhe çmimet dhe vlerësimet...etj);
5. Një projekt – program për lëndën për të cilën konkuron;
6. Diploma ose dëshmi në veprimtari të ndryshme profesionale;
7. Dëshmia mbi zotërimin e një gjuhe të huaj (e preferuar anglisht)/bëjnë përjashtim kandidatët që kanë kryer studimet jashtë shqipërie;
8. Të vërtetojë që ka përvijë mësimdhënie në IAL;
9. Dy referenca nga profesorë/personalitetet e fushës;
10. Vërtetim nga qendra/t e punës së mëparshme që nuk ka penalitete në drejtim të etikës profesionale dhe marrëdhënieve me kolegët;
11. Kopje të letërnjoftimit ose kartës së identitetit;
12. Çertifikatë familjare;
13. Të deklarojë që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
14. Dëshmi e gjendjes mjeksore.

Konkurimi për punonjës mësimorë sa më lartë do të zhvillohet në dy Faza:

(Vlerësimi maksimal 100 pikë)

- | | | |
|-------------------------|---|--|
| 1.1. Faza e parë | - | Shqyrtimi i dosjes së kandidatit; |
| 1.2. Faza e dytë | - | Mësim i Hapur/Intervistë. |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

II. NJËSIA BAZË REGJI, REGJI FILMI & TV:

1. Punonjës mësimorë nga kategoria As. Lektor për lëndën Montazh dhe Zë - 1 (një) punonjës;

1.1. Kandidati/ët për konkursin e punonjësit mësimorë për lëndën Montazh dhe Zë duhet të plotësojnë këto kritere:

- të ketë kryer studimet në arsimin e lartë në profilin përkatës 4 -vjeçar/ master shkencor ose master në arte (mesatarja e përgjithshme e notave mbi 8) në Universitetin e Arteve. Në rastet kur studimet janë kryer në një shkollë të lartë në arte jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njehsuar në MARS;
- të ketë përvojë pune në realizimin e filmave me metrazh të gjatë dhe të shkurtër, si dhe realizimin e programeve dhe dokumentareve televizivë;
- të ketë përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë në fushën përkatëse, brenda ose jashtë Shqipërie minimumi 3 (tre) vjet;
- të ketë realizuar filma ose dokumentarë televiziv (minimumi 4 të tillë);
- të ketë dëshmi kompjuterike programet Adobe Premierë (paketë e plotë) dhe Final Cut Paketë e plotë) ;
- të ketë dëshmi të njërës prej gjuhëve të huaja (Anglisht, Frengjisht, Gjermanisht, Italisht, Rusisht);
- të ketë 2 (dy) rekomandime nga profesorë të fushës;
- të dëshmojë etikë të lartë profesionale dhe morale;
- të mos ketë penalizime nga punëdhënësit e mëparshëm në drejtim të etikës profesionale dhe marrëdhënie me kolegët;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kandidati duhet të dorëzojë pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, këto dokumenta:

1. Kërkesë ku të jetë përcaktuar pozicioni i punës për të cilin ai konkurron;
2. Diplomë origjinale + fletë notash/fotokopje e noterizuar (shkollë e lartë në profilin përkatës për arte, mesatare e përgjithshme mbi 8) e Fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga MASR;
3. Çertifikate origjinalee/fotokopje e noterizuar e kualifikimit/specializimit/trajnitimit të kryer;
4. Jetëshkrim (CV) shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që vërteton elementët e paraqitur në të (studimet; aktiviteti artistik; përvoja pedagogjike si dhe çmimet dhe vlerësimet...etj);
5. Një projekt – program për lëndën për të cilën konkurron;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

6. Diploma ose dëshmi në veprimtari të ndryshme profesionale;
7. Dëshmia mbi zotërimin e një gjuhe të huaj (e preferuar anglisht)/bëjnë përjashtim kandidatët që kanë kryer studimet jashtë shqipërie;
8. Të vërtetojë që ka përvojë mësimdhënie në IAL;
9. Dy referenca nga profesorë/personalitetet e fushës;
10. Vërtetim nga qendra/t e punës së mëparshme që nuk ka penalitete në drejtim të etikës profesionale dhe marrëdhënieve me kolegët;
11. Kopje të letërnjoftimit ose kartës së identitetit;
12. Çertifikatë familjare;
13. Të deklarojë që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
15. Dëshmi e gjendjes mjeksore.

**Konkurimi për punonjës mësimorë sa më lartë do të zhvillohet në dy Faza:
(Vlerësimi maksimal 100 pikë)**

1.1. Faza e parë - Shqyrtimi i dosjes së kandidatit;

1.2. Faza e dytë - Mësim i Hapur/Intervistë.

Konkurrimi do të bazohet në plotësimin e kriterëve profesionale të rektoratit dhe njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht në Ligjin nr.80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL, në Republikën e Shqipërisë”, “Kodin e Punës në RSH” ; Statutin e Universitetit të Arteve, i ndryshuar.

Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në UART, duke filluar nga data **14/01/2019** deri më datë **25/01/2019** ora **14.00**.

Për datën e konkursit kandidatët të informohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Rektoratin e Universitetit të Arteve, çdo ditë nga ora **08.00** deri në orën **14.00**.

Prof. Kastriot ÇAUSHI

**REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE**